



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2020:088971

Datë: 13.05.2024

Numri i dokumentit: 05697384

**Ac.nr.7766/2022**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hysni Bardheci, kryetar i kolegjit, Bujar Muzaqi dhe Enes Mehmeti, anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Robertina Lekaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit M.K., nga fshati ..., Komuna e Lipjanit, të cilin e përfaqëson me autorizim Sh.S., avokat nga Lipjani, kundër të paditurës Komuna e Lipjanit-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt të kontestit kompensimin i pagës jubilarë dhe ushqimit gjatë punës, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, C.nr.737/20, të datës 19.08.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 30.04.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Lipjani–Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, C.nr.737/20, i datës 19.08.2022, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, me aktgjykimin e atakuar C.nr.737/20, të datës 19.08.2022, ka vendosur si në vijim: “I. APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësit M.K. nga fsh. ..., K. Lipjan si e bazuar. II. DETYROHET e paditura Komuna e Lipjanit-Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit t’ia paguaj: në emër të pagës jubilarë për 10 vite përvojë pune shumë prej 202.50 €, si dhe shujtën ditore për 734 ditë të pranisë në punë për periudhën nga data 28.07.2017 deri me dt.31.12.2021 të përllorarit sipas shumë nga 2 euro në ditë, shumë prej 1,468.00 €, me kamatë prej 8% nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi datë 19.08.2022, e deri në përmbushjen definitive të detyrimit, të gjitha këto në afatin prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm. III. DETYROHET e paditura që paditësit t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 208.00 euro dhe në emër të taksës për padi shumë prej 20.00 euro”.

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura në afat ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së Apelit të Kosovës, ankesën e të paditurës ta aprovoj si të bazuar, të prish aktgjykimin C.nr.737/20, të datës 19.08.2022 dhe të refuzoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësit apo lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë ka ushtruar i autorizuari i paditësit duke i kundërshtuar pretendimet ankimore, me propozim që Gjykata e Apelit, ta refuzoj ankesën si të pathemeltë, ndërsa të ndryshoj aktgjykimin sa i përket shpenzimeve të procedurës duke e njohur si shpenzim shumë prej 156.00 euro, në emër të hartimit të përgjigjes në ankesë sipas TOAK-së, ndërsa pjesën tjetër të aktgjykitit ta vërtetoj.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, përmes të autorizuarit të tij, kundër të paditurës, ka parashtruar padi me datën 28.07.2020, për kompensimin e pagës jubilarë dhe ushqimit gjatë punës (shujtave), të precizuar me parashtresën e datës 18.07.2022, duke kërkuar që të aprovohet kërkesëpadia ashtu që të detyrohet e paditura që paditësit t'ia paguaj shumat si në dispozitiv të aktgjykitit të atakuar. E paditura, me anë të përgjigjes në padi, ka kontestuar kërkesëpadinë e paditësit, duke propozuar që e njëjta të refuzohet në tërësi si e pa bazuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit të padisë dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK-së, ka gjetur se janë plotësuar kushtet për dhënin e aktgjykitit pa shqyrtim kryesor të çështjes, dhe ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.737/20, të datës 19.08.2022, me të cilën e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykitit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykitit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se nuk ishte kontestuese se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura si mësimdhënës në Shkollën e Filllore të Mesme të Ulët "Haradin Bajrami" në fsh..., ndërsa në bazë të vërtetimit mbi përvojën e punës me Nr.889, i datës 24.02.2020, të lëshuar nga SHFMU "Haradin Bajrami" në ... konstatohet se paditësi ka 13 vite përvojë pune si mësimdhënës, kurse me vërtetimin për ditët e pranisë në punë nr.889 dt.28.01.2022 të lëshuar nga SHFMU "Haradin Bajrami" në fsh....për periudhën nga dt.28.07.2017 deri me dt.31.12.2021, vërtetohet se paditësi ka gjithsej 734 ditë pune. Tutje gjykata ka arsyetuar se baza juridike e padisë ka rezultuar të jetë e bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, me anë të së cilës në mes tjerash punëdhënësi, sipas nenit 35 par.7 dhe 8 të Kontratës, obligohet që punëmarrësve tu sigurojë, shpenzimet e ushqimit, dhe shpërblimin jubilar, për këto arsye dhe mbi bazën e provave të shqyrtuara, ka konsideruar se

janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit pa shqyrtim të çështjes sipas dispozitës së nenit 152 të LPK-së, dhe ka vendosur që të aprovojë kërkesëpadinë e paditësit dhe të obligojë të paditurën që paditësit t'ia kompensojë shumat e përshkruara si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Vendimin për shpenzimet e procedurës, gjykata ka arsyetuar se ka vendosur konform dispozitave të nenit 452 paragrafi 1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së, dhe se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm dhe kontradiktor me arsyetimin. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Në këtë kontekst në arsyetim e aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për marrjen e aktgjykimit pa shqyrtim kryesor të çështjes siç parashihet me nenin 152 të LPK-së, pasi që e paditura përmes përgjigjes në padi nuk e ka kontestuar gjendjen faktike dhe së në këtë rast nuk kanë ekzistuar pengesa tjera për dhënien e vendimit meritot.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike, pasi që në mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese se paditësi është i punësuar në Shkollën Fillore të Mesme të Ulët "Haradin Bajrami" në ..., ku vazhdon të jetë në të njëjtën pozitë të punës tek e paditura dhe se kjo e fundit, në shkollën ku paditësi është i punësuar, nuk ka kushte të ofrimit të ushqimit në punë përmes restorantit, kuzhinës apo ndonjë formë tjetër, ndërsa nga provat e bashkangjitura është vërtetuar se paditësi nga data 28.07.2017 deri me datën 31.12.2021, ka gjithsejtë 734 ditë të pranisë në punë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht e ka aplikuar të drejtën materiale, pasi që në bazë të nenit 35 par.7, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e cila ka hyrë në fuqi me datën 18.04.2017, përcaktohet se *"Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim, gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro, për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim"*. Në mënyrë të njëjtë këtë çështje e ka rregulluar edhe Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë Nr.prot.105, e datës 22.01.2021, me hyrjen në fuqi të secilës

është shfuqizuar Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë Nr.01B/2056, e datës 18.04.2017, ku në nenin 35 par. 7 ka përcaktuar së “*Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore...*”. Në rastin konkret, duke pasur parasysh se nga gjendja faktike e vërtetuar rezulton se paditësi ka realizuar ditët e punës siç janë të theksua më lart, gjë që është vërtetuar sipas vërtetimit të lëshuar nga Shkolla e Mesme të Ulët në “Haradin Bajrami”, në ..., kjo gjykatë gjeti se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, duke ia njohur shumëat përkatëse të kompensimit për ushqimin gjatë ditëve të pranisë në punë, andaj edhe vendosi që të njëjtin ta vërtetoj sikurse në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me nenin 35, paragrafi 8 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë përcaktohet se: “*Punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit, në vlerë 8.1. për 10 vjet të përvojës në vlerë të 50 % të një page bazë, 8.2. për 20 vjet të përvojës së punës në vlerë të 75% të një page bazë, 8.3. për 30 vjet të përvojës së punës në vlerë të një page bazë, 8.4. për 40 vjet të përvojës së punës në vlerë të 150 % të një page bazë.*” Gjykata e shkallës së parë, me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, duke e detyruar të paditurën që paditësit për 10 vite përvojë pune, t’i paguajë në lartësi prej 50 % të një page bazë në emër të shpërblimit jubilar, me të drejtë është bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, të lidhur dhe nënshkruar nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK-ut) dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës (MASHT), e cila kontratë ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe e cila është në pajtueshmëri të plotë me nenin 90 Ligjit të Punës.

Sa i përket pretendimit së e paditura nuk ka obligim ndaj paditësit pasi që e njëjta nuk është nënshkruar e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, Gjykata e Apelit, gjeti se ky pretendim është i pabazuar, pasi që në bazë të nenit 90 paragraf 1 të Ligjit NR.03/L-212 të Punës është paraparë së “*Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: 1.1. organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe 1.2. organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve*”. Sipas paragrafit 2 të këtij neni përcaktohet së “*Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: 2.1. nivel të vendit, 2.2. nivel të degës, 2.3. nivel të ndërmarrjes*”. Ndërsa në bazë të nenit 2 par.1.2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e cila është nënshkruar nga MASHT-it dhe SBASHK, është paraparë së “*Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat- DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës*”. Ndërsa lidhur me pretendimin se e paditura nuk ka mundësi që të paguaj pagesa shtesë, pasi që nuk ka pranuar mjete financiare nga MASHT apo Ministria e Financave për pagesën shtesë për stafin arsimor, Gjykata e Apelit vlerëson së koordinimi në mes të nivelit qendror dhe lokal në drejtim të alokimit të mjeteve për këtë kategori të pagesave që buron nga Kontrata Kolektive është çështje e brendshme e të paditurës me nivelin qendror dhe kjo assesi nuk mund të afekton në të drejtën e paditësit dhe detyrimin e të paditurës për kompensimin e

ushqimit dhe shpërblimit jubilar duke marrë për bazë faktin së e njëjta është punëdhënës i paditësit.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo konsideroi se të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi lidhur me kamatën është marrë bazuar në nenit 382 të LMD-së, ndërsa vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese dhe në pajtim me dispozitat e nenit 449, 452.1, dhe 453 të LPK-së.

Nga të lartcekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195, paragrafi 1, pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS–PRISHTINË  
Ac.nr.7766/2022, datë 30.04.2024

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari  
Hysni Bardheci